

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2023

LËNDA: QYTETARI DHE PSIKOLOGJI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33	34	35	36				
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Qytetari

1. Për të siguruar barazi, solidaritet, tolerancë midis njerëzve, autoritetet përkatëse miratojnë ligje. Me cilin aspekt të ligjit lidhen këto tipare? **1 pikë**
- A) Vlerën kulturore
 - B) Vlerën sociale
 - C) Vlerën politike
 - D) Vlerën morale
2. Ligji penal: **1 pikë**
- A) rregullon veprimtarinë administrative shtetërore
 - B) përcakton të drejtën e mbiemrit dhe trashëgimisë
 - C) përcakton dënimet dhe masat që merren ndaj autorëve të tyre
 - D) përcakton kujdesin për mirërritjen, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve
3. Kushtetuta e një shteti përmban: **1 pikë**
- A) rregulla administrative
 - B) dënime për vepra penale
 - C) norma në një fushë të caktuar
 - D) parime themelore të drejtësisë
4. Në bazë të hierarkisë së ligjeve, Kushtetuta paraqitet si akti më i lartë e ligji themelor në një shtet. Ky parim lidhet me: **1 pikë**
- A) sovranitetin
 - B) pluralizmin
 - C) kushtetutshmërinë
 - D) parimin e barazisë
5. Shërbimi terciar synon të ndikojë në shëndet përmes praktikave si: **1 pikë**
- A) vaksinimi
 - B) ushqyerja
 - C) aktiviteti fizik
 - D) trajtimi i sëmundjes
6. Parimi i përgjegjësisë ligjore për mjedisin nënkupton: **1 pikë**
- A) përgjegjësinë e shtetit për mjedisin
 - B) ndërgjegjësimin e brezave të rinj për mjedisin
 - C) vlerësimin e mjedisit si "shtëpia" jonë e përbashkët
 - D) ndëshkimin e çdo individi apo subjekti që dëmton mjedisin
7. Plotësimi i nevojave të së tashmes dhe të së ardhmes, pa prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre, lidhet me modelin e: **1 pikë**
- A) zhvillimit cilësor të mjedisit
 - B) zhvillimit të qëndrueshëm
 - C) mjedisit të shëndetshëm për të gjithë
 - D) maksimizimit të përmbushjes së nevojave

8. Sinjalet rrugore me formë trekëndore me kulm nga lart, kontur me ngjyrë të kuqe, sfond të bardhë ose të verdhë dhe me simbol me ngjyrë të zezë janë: **1 pikë**

- A) sinjale rreziku
- B) sinjale detyruese
- C) sinjale dëgjimore
- D) sinjale urdhëruese

9. Sinjalet që paralajmërojnë praninë e rreziqeve në rrugë bëjnë pjesë në kategorinë e sinjaleve: **1 pikë**

- A) vertikale
- B) horizontale
- C) të policit
- D) të ndritshme

10. Ligji përcakton se mjediset e përbashkëta në zonat e banimit, siç janë shkallët, ashensori, hapësirat e gjelbërta rreth pallateve etj., duhet të përdoren njëlloj nga të gjithë banorët. Kjo formë bashkëpronësie është: **1 pikë**

- A) vullnetare
- B) me ortakëri
- C) e qëllimshme
- D) e detyrueshme

11. Në regjimet demokratike kufizimet e të drejtave dhe lirive janë të parashikuara në Kushtetutë dhe vendosen vetëm me ligj. Shpjegoni dy rastet kur legjitimohet kufizimi i këtyre të drejtave. **2 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

12. Shpjegoni këto tri të drejta të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. **3 pikë**

- E drejta për t'u arsimuar _____

- E drejta për të jetuar _____

- Liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar _____

13. Shkolla është institucioni që e ndihmon individin të zhvillohet në disa aspekte. Shpjegoni dy prej tyre: **2 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

14. Shpjegoni dy detyra të shtetit në mbrojtjen e shëndetit të shtetasve. **2 pikë**

1) _____

2) _____

15. Andi shkoi në qendrën tregtare pranë shtëpisë për të blerë një laptop të ri që do t'i shërbejë për punën e tij. Meqenëse nuk kishte mjaftueshëm para me vete ai preferoi të paguante me kartën bankare të debitit. Për situatën e mësipërme, vlerësoni tre kushtet që e bëjnë Andin të quhet konsumator. **3 pikë**

1) _____

2) _____

3) _____

16. Joni sapo ka përfunduar studimet në degën e informatikës. Vlerësoni tre hapa të ligjshëm të cilët janë të nevojshëm për të arritur punësimin e tij. **3 pikë**

1) _____

2) _____

3) _____

17. Kodi Rrugor garanton sigurinë në rrugë dhe në të përcaktohen disa funksione. Shpjegoni dy prej tyre: **2 pikë**

1) _____

2) _____

18. E drejta e informimit është e garantuar me ligj. Përcaktoni tre përfitime nga respektimi i kësaj të drejte. **3 pikë**

1) _____

2) _____

3) _____

Psikologji

19. Neuronit si një qelizë nervore mbështillet nga: 1 pikë

- A) bërthama
- B) citoplazma
- C) membrana
- D) dendritet dhe aksonet

20. Palca e kurrizit dhe truri janë pjesë përbërëse e: 1 pikë

- A) Sistemit Nervor Qendror
- B) Sistemit Nervor Periferik
- C) Sistemit Nervor Somatik
- D) Sistemit Nervor Autonom

21. Cila pjesë e trurit lidhet me organet e shqisave? 1 pikë

- A) Truri i prapmë
- B) Truri i përparmë
- C) Truri i mesëm
- D) Truri i vogël

22. Psikologjia e zhvillimit është degë e psikologjisë e cila merret me studimin e: 1 pikë

- A) ndërveprimet të njerëzve me njëri-tjetrin
- B) rritjes, ndryshimit dhe zhvillimit të njerëzve përgjatë jetës
- C) proceseve mendore dhe lidhjen e tyre me sjelljen e njeriut
- D) faktorëve biologjikë, socialë dhe psikologjikë që ndikojnë në shëndet

23. Majla është gjithmonë e qeshur dhe ka marrëdhënie shumë të mira me shokët e klasës. Ajo përcjell gjithmonë emocione pozitive. Përcaktoni cilit tip personaliteti i përket. 1 pikë

- A) Kolerik
- B) Sanguin
- C) Flegmatik
- D) Melankolik

24. Sipas disa psikologëve, ëndrrat kanë bazë fiziologjike. Përcaktoni cili prej elementëve të mëposhtëm nuk bën pjesë në bazën fiziologjike të ëndrrave, përgjatë gjumit me LSHS. 1 pikë

- A) Të parit
- B) Hipnoza
- C) Emocionet
- D) Të dëgjuarit

25. Fëmijët e vegjël imitojnë veprimet e të tjerëve. Ky lloj të mësuari në psikologji quhet: **1 pikë**

- A) latent
- B) i thjeshtë
- C) riprodhues
- D) model vëzhgimi

26. Fëmijët kanë dëshirë të shohin serialin e preferuar në televizor. Prindërit i ndëshkojnë duke mos i lejuar, pasi nuk kanë përfunduar detyrat.

Në këtë rast kemi të bëjmë me:

1 pikë

- A) ndëshkim pozitiv
- B) përforcim negativ
- C) teknikë formësimi
- D) ndëshkim negativ

27. Sipas psikologëve sjelljet konsiderohen jonormale nëse veprimet:

1 pikë

- A) janë jotipike dhe konform normave
- B) janë të ndryshme dhe vlerësohen pozitivisht
- C) shkaktojnë reagime tipike dhe të zakonshme
- D) shkaktojnë paaftësi për të ndërtuar marrëdhënie sociale

28. Qëndrimi është prirja për të:

1 pikë

- A) ndierë përkundrejt një grupi njerëzish
- B) menduar përkundrejt një grupi njerëzish
- C) vepruar përkundrejt një klase njerëzish, objekteve ose një ideje
- D) ndierë, menduar dhe vepruar përkundrejt njerëzve, objekteve ose një ideje

29. Identifikoni tri aspekte të sjelljes që studion psikologjia sociale.

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

30. Dëmtimi ose ndërprerja e punës së hipofizës ndikon në ndërprerjen e rritjes së trupit. Shpjegoni tre ndikime të tjera që mund të ndodhin:

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

31. Për përballimin e stresit mund të përdoren disa teknika. Shpjegoni nga një karakteristikë për secilën prej teknikave të përballimit të stresit: **2 pikë**

Teknika e relaksimit progresiv të muskujve _____

Imagjinatë e drejtuar _____

32. Detjona po priste fëmijën e saj të parë. Ishte djalë. Cili është hormoni që ndihmoi në përcaktimin e seksit të fetusit? Përse është i rëndësishëm prodhimi i tij? **2 pikë**

Hormoni _____

Rëndësia _____

33. Shpjegoni dy vështirësi me të cilat një adoleshent ndeshet në jetën e përditshme, në marrëdhënie me të rriturit. **2 pikë**

1) _____

2) _____

34. Sipas psikologut Zhan Piazhe, zhvillimi mendor i fëmijës kalon në katër stade. Shpjegoni dy stadet e poshtëshënuara. **2 pikë**

Stadi sensomotor _____

Stadi paraoperacional _____

35. Bazuar në llojin e informacionit që ruhet në kujtesë, psikologët kanë përcaktuar tre tipat e kujtesës. Përshkruani llojin e informacionit që ruhet në të. **3 pikë**

Kujtesën episodike _____

Kujtesën semantike _____

Kujtesën procedurale ose të shprehive _____

36. Mbështetur te psikologët, analizoni karakteristikat për secilën nga format më tipike të çrregullimit të të ngrënit.
3 pikë

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____
